

**Gjykata e qarkut në Prizren**  
**P.nr.11/10**  
**10.11.2011**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

### **GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN**

Gjykata e qarkut në Prizren, i përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Witold Jakimko si kryetar i trupit gjykues, gjyqtari i EULEX-it Tore Thomassen dhe gjyqtarja Raima Elezi,

*të ndihmuar nga:*

Robina Struthers, Jacqueline Ryan, Valentina Gashi Eriona Bitri Breeding, Sonila MacNeil, Tsvetelina Zhekova, Vlora Johnston, Nexhmije Mezini dhe Natasa Malesevic, si procesmbajtësit,

*në lëndën penale ndaj:*

1. Të pandehurit S.N, djali i ... dhe ... (vajzërisë ...) i lindur më .... në ...., me vendbanim në ....” nr. ...., i papunë, i martuar, gjashtë fëmijë, ka kryer shkollën e mesme, mekanik, shqiptar kosovar, shtetas i Republikës së Kosovës, me gjendje të dobët ekonomike, i ndjekur për vepra të ngjashme penale.
2. Të pandehurit M.K, djali i ... dhe ... (vajzërisë ...) i lindur më ... në ..., me vendbanim ..., ..., i martuar, 5 fëmijë, ka kryer shkollën fillore, shtetas i Republikës së Kosovës, me gjendje mesatare ekonomike, vuan dënimin për veprat e tjera penale.
3. Të pandehurit T.K, djali i ... dhe ... (vajzërisë ...), i lindur më ... në ..., me vendbanim të tanishëm në rrugën “... ” ..., i martuar, 3 fëmijë, i papunë, ka kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me gjendje mesatare ekonomike.
4. Të pandehurit S.K, djali i ... dhe ... (vajzërisë ...), i lindur më .... në ..., banon në ....., i martuar, 2 fëmijë, ka kryer fakultetin e metalurgjisë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me gjendje mesatare ekonomike.

5. Të pandehurit V.K, djali i ... dhe ... (vajzërisë ...) i lindur më .... në ..., ku edhe banon në rrugën “....., i martuar, dy fëmijë, ka kryer shkollën e mesme, programor, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me gjendje mesatare ekonomike.
6. Të pandehurit A.B, djali i ... dhe ....., (...) i lindur më ... në ..., ku edhe banon, në rrugën ....., i martuar, tre fëmijë, ka kryer shkollën e mesme, tregtar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me gjendje mesatare ekonomike.
7. Të pandehurit N.K, djali i ... dhe ... (vajzërisë ...), i lindur më ... në ..., ku edhe banon në ....., i martuar, tre fëmijë, ka kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, punon në ndërtim, me gjendje mesatare ekonomike.

*akuzohet sipas*

Aktakuzës PP.nr.190/09 të datës 3.12.2009, e cila i akuzoi të pandehurit S.N, M.K, T.K, S.K, V.K dhe A.B për veprën penale të detyrimit nga neni 267 (2) në lidhje me (1) të kodit penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm “KPK”), të pandehurin N.K akuzoi për veprën penale të kontraktimit të përfitimit jo proporcional nga neni 270 i KPK.

*të përshkruar më poshtë:*

të pandehurit S.N, M.K, T.K dhe S.K

Duke filluar me datën 23.11.2007 dhe pas kësaj date të akuzuarit duke vepruar si pjesëtar të bashkimit, me synim të përfitimit të kundërligjshëm për ata ose për palën e tretë përdorën dhunën dhe bënë kërcënime të rënda ndaj palës së dëmtuar Sh.Mt, duke detyruar të njëjtin të veprojnë në atë mënyrë që të dëmtoj pronën e vet. Ata përfitojnë pasuri të madhe duke shfrytëzuar gjendjen e vështirë financiare të palës së dëmtuar, prandaj me datën 23.11.2007 i pandehuri S.N me kërkesën e palës së dëmtuar i jep shumën prej 23.000€ me kamatë mujore prej 11% ose 2.500€ për muaj, prandaj pala e dëmtuar e pagoi kamatën për 3-4 muaj. Gjithashtu, S e njofton palën e dëmtuar se për shkak të obligimeve që ai i kishte ndaj të pandehurit M.Kj pala e dëmtuar duhet prej tani të paguan kamatën të pandehurit M.Kjit. Pala e dëmtuar vazhdon të paguan kamatën M.Kjit edhe për dy muaj të tjerë.

Meqenëse M ishte duke vuajtur dënimin (në burg) kamata duhej të paguhej të pandehurit T.K, vëllait të M, edhe për 4 muaj të tjerë, prandaj me datën 24.07.2008 ai dha shumën prej 13.000€ T.Kjit, në emër të borxhit fillestar, kamata në shumë prej 10.000€ mbet që të paguhet. Gjithashtu me datën 31.12.2008 pala e dëmtuar i dha 1.000€. Duke mos qenë i aftë të paguaj kamatën e mbetur bëri një marrëveshje me T.Kjin që të shtyn borxhin deri më 01.05.2009 por me këtë datë pala e dëmtuar është dashur të paguan 15.000€ vetëm

për kamatë. Në ndërkohë me kërkesën e palës së dëmtuar i pandehuri S.K u përfshi me qëllim që të shtyn afatin e pagesës së borxhit dhe të kamatës, por S.K kërkoj 3.000€ nga pala e dëmtuar si shpërblim për ndërmjetësimin e bërë midis tij dhe të akuzuarit T.Kj. Prandaj, pala e dëmtuar ishte i detyruar të paguaj 3.000€ S.Kt me datën 01.09.2009. Pala e dëmtuar nuk ka pasur mundësi që të mbuloj kërkesat e tilla ndaj S.Kt. Se e merr veturën e tij Golf 4, me ngjyrë të përhimë me targa 530-KS-865, prandaj borxhi bashkë me kamatën arrin shumën prej 52.000€.

Kësodore kanë kryer veprën penale të detyrimit nga neni 267 (2) në lidhje me (1) të KPK.

## II.-të pandehurit V.K dhe A.B

Duke filluar me datën 01.12.2007 dhe pas kësaj date të akuzuarit duke vepruar si pjesëtar të bashkimit, me synim të përfitimit të kundërligjshëm për ata ose për palën e tretë përdorën dhunën dhe bënë kërcënime të rënda ndaj palës së dëmtuar Sh.Mt, nga Prizreni, duke detyruar të njëjtin të veproj në atë mënyrë që të dëmtoj pronën e vet. Ata përfitojnë pasuri të madhe duke shfrytëzuar gjendjen e vështirë financiare të palës së dëmtuar, prandaj me datën 01.12.2007 me kërkesën e palës së dëmtuar i pandehuri V.K i dha para me fajde palës së dëmtuar në shumë prej 10.000€ me kamatë mujore prej 10%. Pala e dëmtuar ishte i detyruar të paguajë shumën prej 1.000€ për dy muaj, por me datën 01.02.2008 i pandehuri për herë të dytë i jep të dëmtuarit para me fajde në shumë prej 15.000€ me kamatë mujore prej 10%. Pala e dëmtuar e shfrytëzon atë të paguajë kamatën mujore deri më muajin maj 2008 në shumë prej 2.500€, do të thotë se shuma gjithsej e paguar si kamatë ishte 7.500€. I pandehuri V.K si ndërmjetësues midis A.B dhe palës së dëmtuar i dha palës së dëmtuar shumën prej 25.000€ me fajde në muajin maj 2008 me kamatë mujore prej 10%, ose kamatë prej 2.500€ për muaj. I dëmtuari arriti të paguan vetëm kamatën deri më 31.09.2007, dhe nuk ishte në gjendje të paguajë borxhin fillestar e cila ishte duke u rritur. I pandehuri A e detyroi të dëmtuarin të shet tokën në sipërfaqe prej 6 ari e cila ndodhet afër hotel “Menes” për çmim prej 87.500€, dhe nga kjo shumë 70.000€ do të llogaritej në emër të fajdes, ndërsa pjesa e mbetur prej 17.500€ ai i dha nënës së tij

Kësodore kreu veprën penale të detyrimit nga neni 267 (2) në lidhje me (1) të KPK.

## III.-i pandehuri N.K

Me datën 01.11.2007 i pandehuri N.K nga Suhareka, me qëllim të përfitimit jo proporcional për vete ose për palën e tretë, duke shfrytëzuar gjendjen e vështirë financiare të palës së dëmtuar Sh.Mt nga Prizreni, i dha para në shumë prej 50.000€ me kamatë mujore prej 11% ose 5.500€ për muaj. Pala e dëmtuar pagoi kamatën deri më 01.09.2008. Meqë i dëmtuari nuk ishte në gjendje të vazhdojë me pagesën e kamatës i pandehuri Ne shkon në shitoren e tij të tekstilit dhe merr mall në emër të borxhit, në shumë prej 12-13 mijë Euro; ai gjithashtu bënë marrëveshje me palën e dëmtuar se më 31.08.2009 pala e dëmtuar do të kthej borxhin fillestar bashkë me kamatën.

Kësodore kreu veprën penale të kontraktimit të përfitimit jo proporcional nga neni 270 të KPK.

*pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore*

më 13, 14, 15.09.2011, 04, 24, 25.10.2011 dhe 10.11.2011, në praninë e të pandehurit S.N, avokatit të tij mbrojtës, Osman Zajmi, të pandehurit M.K, avokatit të tij mbrojtës Kosovare Kelmendi, të pandehurit T.K, avokatit të tij mbrojtës Pjetër Përgjoka, të pandehurit S.K, avokatit të tij mbrojtës Shaban Berisha, të pandehurit V.K, avokatit të tij mbrojtës Nexhat Elshani, të pandehurit A.B, avokatit të tij mbrojtës Brahim Sopa, të pandehurit N.K, avokatit të tij mbrojtës Ethem Rugova dhe prokurorit publik të qarkut në Prizren, Mehdi Sefa,

*merr këtë:*

## AKTGJYKIM

1. Në pajtim me nenin 390 paragrafi 3 i kodit të procedurës penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme "KPPK"), **të pandehurit S.N, M.K, T.K, S.K, V.K, dhe A.B nuk shpallen fajtor** për veprat penale të detyrimit nga neni 267 (2) në lidhje me (1) të KPK dhe **i pandehuri N.K nuk shpallet fajtor** për veprën penale të kontraktimit të përfitimit jo proporcional nga neni 270 i KPK, sipas përshkrimit të paraparë me aktakuzë (PP.nr.190/09 të datës 03.12.2009);

2. Në pajtim me nenin 103 të KPPK shpenzimet e kësaj procedure nga neni 99 paragrafi 2 nën paragrafi 1 deri në 5 të KPPK, shpenzimet e nevojshme e të gjithë të pandehurve përfshirë shpenzimet gjyqësore dhe shpenzimet e nevojshme të avokatëve mbrojtës do të paguhen nga mjetet e buxhetit;

## ARSYETIMI

I. Rrjedha procedurale.

Me datën 2.10.2009 prokurori publik i qarkut lëshoi aktvendimin për fillimin e hetimeve ndaj S.Nt, M.Kit, T.Kit, S.Kt, V.Kt, A.B dhe N.Kt.

Me datën 3.12.2009 prokurori publik ushtroi aktakuzën (PP nr. 190/09, të datës 3.12.2009) gjykatës së qarkut në Prizren.

Me datën 6.01.2010 gjyqtari i konfirmimit i gjykatës së qarkut në Prizren konfirmoi aktakuzën ndaj të gjithë të pandehurve.

Me datën 15.04.2011 Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it e caktoi lëndën gjyqtarëve të EULEX-it i gjykatës së qarkut në Prizren.

Me datën 7.06.2011 shqyrtimi paraprak u mbajt në gjykatën e qarkut në Prizren.

Me datën 13.09.2011 filloi shqyrtimi kryesor dhe vazhdoi me datat 13, 14, 15.09.2011, 04, 24, 25.10.2011 dhe më 10.11.2011. Asnjë kundërshtim nuk ka pasur ndaj përbërjes së trupit gjykues.

Me datën 10.11.2011 aktgjykimi u shpall në GJQ në Prizren.

### III. Prova të administruara.

1. Gjatë seancës së datës 24.09.2011 gjykata pranoi si provë dokumentet në vijim:

E1 Aktgjykimi P.133/2008

E2 Aktakuza e PPK të datës 27.07.2009, kundër Sh.Mt dhe A.Bt dhe Sh.Mt ishte në atë lëndë të akuzuar se më 26.06.2009 në Prizren.

E3. Përgjigja nga zyra e prokurorit disiplinor numri rendor ZPD/09/KB/0879 i datës 9.09.2009 Sh.Mt. Ankesa është hedhur poshtë.

E4. Deklarata e Ar.B i cili deklaroi rreth rastit të nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së lokalit afarist që ndodhet në Lamella A5, njësia afariste 9 Ortakol 3 me sipërfaqe prej 30 metër në katror, Ar.B e shiti personit të quajtur Sh.M nga Prizreni njësinë lartpërmendur për çmim prej 2,500 Euro. Me datën 25.10.2008, ai pranoi shumën për të cilën janë marr vesh bashkërisht.

E5 Deklarata e Sh.Mt për përmbajtjen e cila mund të krahasohet me deklaratën tjetër dhe është e përmbajtjes së njëjtë përveç faktit se Sh.M ishte ajo palë tjetër që e nënshkroi dokumentin.

E6 Edhe një deklaratë e Sh.Mt, ku ai deklaroi se ka shitur Sh.St pronën e patundshme me sipërfaqe prej 4 ari që ndodhet në ngastrën kadastrale nr. 5147 në lokacionin Kamenica. Ai e shiti pronën e lartpërmendur me çmimin e shitjes prej 90,000 Eurove.

E7 Kontrata e shitblerjes e pronës së paluajtshme midis Sh.St dhe Sh.Mt lidhur me ngastrën kadastrale nr. 5328/4 që ndodhet në -Kamenicë me sipërfaqe prej 200 metër katror (E7); çmimi i blerjes ishte 90,000 Euro.

E8 Edhe një deklaratë është bërë me datën 4.10.2007, nga ana e Sh.St ku Sh.S deklaroi se Sh.Mt e shiti shtëpinë që ndodhet në Kamenicë në Prizren. Kjo ishte ngastra kadastrale nr. 5328 dhe çmimi i shitjes ishte 90,000 Euro.

E9 Një dokument tjetër si provë është dokumenti nga Ministria e shërbimeve publike, Agjencia kadastrale e Kosovës e datës 11.12.2008, me aktvendimin vijues: kërkesa e A.B nga Suhareka aprovohet. A.B kërkoi bartjen e pronësisë prej pronarit të mëparshëm Sh.St nga Prizreni te pronari i ri A.B të ngastrës kadastrale nr. 5251/4 në sipërfaqen prej 0.06,02 ha në komunën e Prizrenit.

E10 Marrëveshja me shkrim e lidhur me datën 1.11.2007 midis S.Nt dhe Sh.Mt

E11, E12, E13 Faturat e datës 22.08.2008 dhe 11.09.2008 dhe 5.12.2008 (E11, 12, 13).

2. Gjatë seancës së datës 10.11.2011 gjykata pranoi si provë dokumentet vijuese:

C1: Shkresa zyrtare nga drejtoria regjionale në Prizren.

C2: Të dhëna për rastet e ushtruara ndaj të pandehurve.

C3: INDPP1818/09 Prokuroria publike komunale në Prizren – ndaj Sh.Mt

C4: Kopja me numër PP336/09 Prokuroria publike komunale në Prizren – Aktakuza ndaj N.Kt

C5: PP1731/08 propozimi akuzues ndaj S.Nt për kërcënim

C6: Propozimi akuzues i datës 7.05.2009, ndaj S.Nt për zhvendosjen e telit të lidhur me njehsorin elektrik.

C7: PP2716/2010, Aktakuza midis tjerash ndaj T.K, Lëndime të rënda trupore.

C8: PP1942/05 ndaj N.Kt, Detyrim,

C9: PP115/05 ndaj T.K gjithashtu aktakuzë, lëndime të rënda trupore

C10: Aktgjykimi, Gjykata e qarkut në Prizren 133/2008, midis tjerash M.K dhe T.K, Vrasje.

C11: Të dhënat nga zyra e prokurorisë komunale në Prizren ku përmenden lëndët e ushtruara ndaj të pandehurit tanë në lëndë të ndryshme dhe na njofton se çka ka ndodhur me ato raste. Disa lëndë janë në pritje.

C12: Propozimi akuze ndaj T.K 2540/2003, pjesëmarrje në lëndim të lehtë trupor.

C13: Të dhëna lidhur me Sh.Mn nga zyra e prokurorisë komunale në Prizren për lëndë të raportuara prokurorisë nga ai.

C14: Aktakuza 1324/2003, për falsifikimin e dokumenteve ndaj T.K.

C15: Aktakuza 2543/2003 ndaj T.K, prodhimi i armëve për kryerjen e veprave penale

C16: Propozimi akuzues ndaj Sh.Mt, lidhur me rrymën elektrike dhe vjedhjen e numrit elektrik PP1864/2004.

3. Gjatë seancave gjyqësore janë dëgjuar dëshmitarët vijues (të gjitha janë kërkuar me aktakuzë):

- S. M. J nga ....., rruga “.....” nr ...
- Sh. N. S, nga ....., rruga “.....” nr .....
- A. H. Br nga ....., rruga “.....” nr ....
- Ar. H. B nga ....., rruga “.....” nr .....
- B. A. M nga ....., lagjja ....., rruga “.....” nr .... dhe
- F. B. B nga ....., rruga ”.....” nr .....

4. Pala e dëmtuar *Sh.M* u dëgjua me datën 13.09.2011.

5. Të pandehurit u dëgjuan me datën 15.09.2011 dhe 4.10.2011



6. Provat që ndikojnë në konstatimet e gjykatës qartë shtjellohen në paragrafët në vazhdim. Provat e tjera nuk kanë pasur ndikim të drejtpërdrejt në përmbajtjen përfundimtare të shqiptimit.

#### IV. Gjendja faktike.

1. Të pandehurit dhe të dhënat e tyre personale janë përmendur në shqiptim prandaj nuk ka nevojë të përsëriten në gjendjen faktike.

2. Pala e dëmtuar Sh.M nga Prizreni është tregtar. Ai e kishte shitoren private dhe kryesisht punonte me tekstil. Gjatë vitit 2007 Sh.M u ballafaqua me disa vështirësi financiare me afarizmin e tij, prandaj ai ishte i detyruar të kërkojë ndihmë.

3. Mirëpo nuk u dëshmuua përtej dyshimit të arsyeshëm se pala e dëmtuar ka marr para nga **S.N** si borxh dhe më pak se çka ishin kushtet e borxhit të supozuar. S.Nt Sh.M e prezantoi veten si agjent i SHIK (Agjencisë së inteligjencës së Kosovës). S.N nuk ka pasur marrëdhënie afariste me vëllezërit K ose S.K; ai nuk i huazoi palës së dëmtuar paratë. Ai pranoi se i ka dhënë palës së dëmtuar dy herë letërnjoftim dhe se mendohej t'i ndihmonte Sh.Mt por jo duke i huazuar ose dhënë para.

4. Sh.M kërkoj nga B.M borxh prej 7.000 eurove. Dëshmitari nuk ka pasur para të tilla. Atë ditë Sh.M e vizitoi dy herë atë ditë. B.M kontaktoi atë me shokun e tij **S.Kn** i cili i dha borxh prej 7000 eurove. K i dha paratë Mt pa kamatë. Si garanci për borxhin S.K mori veturën e Sh.Mt dhe PD barti të drejtat e veturës te S.K. Në ndërkohë kur erdhi koha e kthimit të parave Sh.M shkoi në Shqipëri me veturë. Sh.M i falsifikoi dokumentet e veturës dhe e barti veturën në emrin e vet në mënyrë që të kalojë kufirin. Sh.M është ndjekur për shkak të sjelljes së tij (shih provat C3 dhe C13). Sipas dëshmitarit Sh.M vullnetarisht i dha S.Kt çelësat e veturës. Në kufi Mo dhe K raportuan policisë M dhe prona e veturës u bart përsëri prapa te S.K. S.K e shiti veturën për 6.300 euro që ishte më pak nga ajo borxhi i pakthyer i dhënë Mt.

5. Nuk ka pasur përdorim të dhunës dhe as kërcënim të rëndë ndaj Sh.Mt nga **M.K, T.K, S.N dhe S.K**. Vëllezërit K nuk kanë pasur rol në huazimin e parave nga S.N (procesverbali i 13.09.2011, faqe 13). Ai nuk ka pasur “punë me huazimin e parave me

kamatë” me vëllezërit K. Sh.M gjithashtu pranoi faktin se M.K ishte *tempore crimini* kryesisht i burgosur dhe duke vuajtur dënimin e tij për vrasje. Ai nuk pagoi asnjë para M.Kjit kur i pandehuri akoma nuk ishte në paraburgim (procesverbali i 13.09.2011, faqe 16). Ai as nuk ishte në gjendje të përshihet në aktivitete penale në atë kohë (krahaso me provën C10). **T.K** tha se ai nuk ka pasur asnjë lidhje me Sh.Mn nuk i kam huazuar asnjë para dhe ai nuk dinte fare që S.N i ka dhënë para atij.

6. Nuk është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se pala e dëmtuar ka marr para nga **V.K** si borxh dhe natyrisht shumë më pak nga që ishin kushtet e borxhit të supozuar. Sh.M e prezantoi veten si afarist i suksesshëm dhe nuk ka baza të dyshohet se është person pa përvojë ose i paaftë të gjykojë. Sa i përket gjendjes së vështirë financiare nga ana e V.Kt nuk ka pasur asnjë dijeni për ato rrethana.

7. **N.K** i dha Sh.Mt një borxh afatshkurtër prej 50.000 eurove por pa asnjë kamatë. Paratë nuk janë kthyer deri në fund të shqyrtimit kryesor. Sh.M pohoi N.Kt se ka dy ngarkesa të tekstit në Serbi që vijnë nga Singapori. Ai i dha N.Kt këtë argument si arsye për të kërkuar borxh. N.K në fillim nuk u pajtua por më vonë mori vendimin pozitiv duke marr parasysh faktin se Sh.M ka pasur shumë shitore. Ata u pajtuan që Shi të kthejë borxhin për dy javë deri në një muaj. Kjo është rregulluar në shitoren e Sh. N.K mori vetëm ca mall nga shitorja e Sh.Mt si kthim i borxhit e cila nuk tejkaloi 12.000 eurot. (procesverbali i 15.09.2011, faqe 9).

8. Parcela e tokës e përshkruar në aktakuzë (parcela nr 5215/4 (list.p.nr.12727 me sipërfaqe prej 0.06,02 ha – shih provën E9) është shitur A.B nga Sh.S (procesverbali i 14.09.2011). O.B dhe S.J të dy ishin të pranishëm në çastin e lidhjes së kontratës dhe kur kësti i parë prej 30.000 eurove është paguar. Gjithçka ishte me pajtim dhe me marrëveshje të përbashkët. A.B nuk ishte i përfshirë në asnjë shtypje mbi Sh.Mn (procesverbali i 13.09.2011, faqe 20) dhe ai ishte tolerant dhe i sinqertë ndaj tij (procesverbali i 14 shtat. faqe 6). Kontrata e shitblerjes së tokës së përmendur në aktakuzë ishte plotësisht e vlefshme dhe obligues në kuptimin ligjor. Askush nuk ndërmoi ndonjë hap ligjor me qëllim që ta rikthejë.

9. **Sh.M** nuk i pagoi borxhet nëpërmjet afarizmit të tij por zakonisht paguante borxhet e tij ashtu që huazonte prej një personi te tjetri (procesverbali i 13.09.2011, f.20).

10. Nuk ka pasur asnjë planifikim, asnjë detyrë e caktuar individuale dhe asnjë veprim koordinues sipas planit operativ në sjelljet e të pandehurve. Të pandehurit vëllezërit K, N dhe K dhe Ky bashkë me A.B nuk vepronin përbrenda grupit të kryerësve.

V. Analizat individuale të provave dhe konstatimet ligjore.

Pozita e vëllezërve M dhe T.K dhe S.N.

Sh.M prej fillimit të shqyrtimit kryesor nuk ka qenë i qëndrueshëm në dëshmitë e tij. Kur u pyet për përdorimin e dhunës ndaj tij ai shpjegoi se mori përsipër të kthejë borxhin e S.Nt. Ai deklaroi se nuk është detyruar nga askush me përdorimin e dhunës që të huazoj para nga S.N. Me datën 14.09.2011 për procesverbalin ai mohoi përsëri çfarëdo përdorimi të dhunës dhe as kërcënime të rënda ndaj tij nga M.K, T.K, S.N dhe S.K. Ai mohoi se vëllezërit K kanë pasur ndonjë rol në huazimin e parave prej S.Nt. Ndonëse në paragrafin e njëjtë ai pohoi se huazojë para në shumë prej 23,000 € nga S.N. Në paragrafin tjetër ai tha se mori garanci për këtë shumë. Fjalja më lart është pasuar nga deklarata e theksuar kinse për shumën i është kërkuar nga S.N të kthejë vëllezërve K, të gjitha paratë që i pagoi si kamatë janë paguar në emër të S.Nt dhe jo në emër të vëllezërve K. Ai pastaj deklaroi se sa i përket vëllezërve K ai nuk ka pasur “punë me huazimin e parave me kamatë”. Ai mohoi se ka pasur ndonjë kontakt me ata. Sh.M gjithashtu pranoi faktin se M.K ishte *tempore crimini* kryesisht i burgosur duke vuajtur dënimin. Pala e dëmtuar gjithashtu pranoi se ai nuk pagoi asnjë para M.K kur i pandehuri akoma nuk ishte në paraburgim (f.16). Paqëndrueshmëria në dëshmi të palës së dëmtuar ishte e dukshme se njëherë foli për garancinë e siguruar S.Nt për borxhet e këtij të fundit, pastaj Sh.M tha nuk ka pasur asnjë transferim parash midis tij dhe S.Nt por në fund ai tha se mori 23.000 euro nga S.N dhe ishte i detyruar t’i kthejë vëllezërve K. Edhe Sh.M edhe vëllezërit K deklaruan se nuk ka pasur transferim parash nga ata te pala e dëmtuar; me fjalë të tjera kurrfarë parash nuk i janë huazuar atij nga ata. S.N mohoi se ka dhënë ndonjë para Sh.Mt. Disa dokumente janë dhënë nga prokurori me aktakuzë. Ekziston një marrëveshje me disa shënime kinse e nënshkruar nga S.N. Zyra e prokurorisë nuk i ka dhënë gjykatës origjinalet. S.N e mohoi nënshkrimin e tij mbi të. Gjykata as nuk ka qenë në gjendje të kërkojë mendimin e ekspertit të grafologjisë për shkak të mungesës së

materialit origjinal krahasues. Praktika në tërë botën është se eksperti refuzon të shtjellojë mendimin vetëm duke u bazuar në fotokopje. Ndonëse gjykata zyrtarisht pranoi provën e përmendur si provë E10 prapëseprapë ajo nuk ka asnjë vlerë për të dëshmuar diç.

S.N tha se Sh.M e prezantoi veten si agjent i SHIK-ut (Agjencia e inteligjencës së Kosovës). S.N mohoi çdo marrëdhënie afariste të supozuar me vëllezërit K ose me S.Kn, ai mohoi se ka dhënë para palës së dëmtuar. Ai pranoi se i ka dhënë para palës së dëmtuar letërnjoftim dy herë dhe se mundohet ta ndihmon Sh.Mn por jo duke huazuar ose duke dhënë para.

M.K ishte *tempore criminis* kryesisht duke vuajtur dënimin e tij për vrasje. Prandaj ai as që ka qenë në gjendje të jetë i përfshirë në aktivitete penale në atë kohë (krahaso me provën C10). T.K deklaroi se ai nuk ka pasur asnjë lidhje me Sh.Mn nuk i kam huazuar atij asnjë para dhe ai nuk dinte asgjë për paratë që i janë dhënë atij nga S.N. Asnjë nga dëshmitarët madje nuk përfshiu vëllezërit K në ndonjë veprim fajësues.

#### Qasja e PD huazimeve dhe aktiviteteve afariste.

Sh.M gjatë dëgjimit në sallën e gjykitimit njëherë tha se ai nuk paguante borxhet përmes afarizmit të tij por zakonisht paguante borxhet e tij duke huazuar prej një personi te tjetri (procesverbali i 13.09.2011, f.20). Kjo deklaratë është shumë e rëndësishme me qëllim që të përshkruajë qasjen e tij për mënyrën si e zhvillon afarizmin dhe kjo ka ndikim në besueshmërinë e tij. Ai merrte borxhet me paramendim pa asnjë qëllim që t'i kthejë ato. Marrja e borxheve ka qenë *modus vivendi et operandi* i tij. Borxhet nuk i duheshin për zhvillimin e afarizmit të tij por faktikisht për konsumim të tanishëm dhe për të kthyer detyrimet e mëparshme.

Besueshmëria e PD sa i përket kursit të kamatës.

Zyra e prokurorisë nuk i ka dorëzuar gjykatës asnjë provë që dëshmon se cili ka qenë kursi i kamatës. Nuk ka prova që mbështesin deklaratat e vetme të palës së dëmtuar. Shënimet (kopjet) që janë dorëzuar bashkë me aktakuzën kanë qenë kryesisht të bëra nga vetë Sh.M. E vetmja që kinse është nënshkruar nga S.N nuk ishte origjinali. Duke pasur ndër mend që i pandehuri e mohoi nënshkrimin e tij dhe nuk ka pasur asnjë mënyrë që të merret mendimi i ekspertit të grafologjisë gjykata nuk ka mundur të merr këtë provë parasysh. Duke ditur faktin e pranuar nga Sh.M se ai merrte borxhe me qëllim që të

kthejë borxhet e tij të mëparshme dhe se kjo ishte receta e tij në jetë dhe problemi financiar është shumë vështirë të mbështetet në deklaratën e tij se ai ishte viktimja e detyrimit dhe e përfitimit jo proporcional.

#### *Përshkrimi i dhunës dhe i kërcënimeve.*

Nuk ka pasur asnjë përshkrim i mënyrës se si dhuna ose kërcënimet janë përdorë dhe se kur ndodhi kjo. Gjykata supozon se prokurori nuk i kaloi këto elemente të veprës penale me aq kujdes sa që të nxjerr një përfundim se pala e dëmtuar gjatë shqyrtimit kryesor e mohoi në fund të gjitha ato kërkesa ligjore mandatorë që e përbëjnë këtë lloj të veprës penale. Natyrisht mund të pyesim edhe një pyetje nëse N, vëllezërit K dhe K kanë vepruar në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën mënyrë. Është e pamundur të mësohet diçka për aktakuzën. Duhet të përfundohet se pozita e secilit të pandehur veç e veç nuk është individualizuar dhe nuk pasqyron kontributin e tyre veprës penale. Ato mangësi e dobësojnë në mënyrë dramatike aktakuzën si të tillë madje as pa hyrë më thellë në provat e dorëzuara nga prokuroria.

#### *Bashkimi i organizuar – elemente ligjore.*

Nuk ka pasur krim të organizuar në kuptim të termit të paraparë me statut; nuk ka pasur planifikim, nuk ka pasur detyra individuale dhe nuk ka pasur veprim të koordinuar sipas planit operativ. Dispozita e përcakton faktin e të qenit pjesëtar i grupit si rrethanë rëndësuese prandaj neni 267§2 përcakton sanksione më të rënda. Përkufizimi i grupit duhet të bazohet në elemente objektive. Ky nuk është krimi i organizuar meqenëse ky lloj i krimit parashihet me një nen tjetër por akoma duhet të përmbajë disa elemente të planifikimit dhe të pajtimit të qëllimshëm. Prokuroria nuk shpjegon çfarë lloj i bashkimit është themeluar nga të pandehurit, në çfarë marrëveshje është bazuar, cilat kanë qenë rregullat e funksionimit të tij. A kanë përdorë ata dhunën dhe kërcënimet bashkë a po veç e veç? Nuk ka prova për rrethanat se vëllezërit K, S.K dhe S.N vepruan si grup duke kryer ose duke tentuar të kryejnë këtë vepër penale.

#### *Parregullsitë dhe mospërputhjet në aktakuzë*

Pa dëshmuar bile edhe një element të veprës penale nuk ka mënyrë që të ngarkohet vepra penale e detyrimit të përcaktuar me nen.267§2 të KPK të pandehurve

përkatës. Pala e dëmtuar në mënyrë të qartë mohoi përdorimin e çfarëdo dhune ndaj tij nga T.K, M.K dhe S.N. Për më shumë Sh.M vetë pranoi se asnjë nga të pandehurit kishte njohuri për gjendjen e tij ekonomike. Madje duke marr parasysh besueshmërinë e tij sa i përket faktit se ai vërtetë i huazoi këto para nga T.K, M.K dhe S.N, nuk ka as elemente të veprës penale të kontraktimit për përfitim jo proporcional të përcaktuar me nenin 270 të KPK. Sh.M zakonisht e prezantonte veten si afarist i suksesshëm dhe në atë mënyrë është pandehur nga të gjithë. Nuk ka madje asnjë shenjë të papërvojës ose paaftësisë së tij.

Gjykata i ka pikasur disa mangësi në aktin e aktakuzës të cilat nuk janë rregulluar gjatë shqyrtimit kryesor nga autori i aktakuzës. Së pari nuk ka asnjë datë përfundimtare të kryerjes së veprave penale për të cilat të pandehurit janë akuzuar. Autori i aktakuzës nis akuzën e parë me “Duke filluar prej datës 23.11.2007 dhe përtej kësaj date” por nuk thirret në datën përfundimtare të kryerjes. Sipas mendimit të gjykatës kjo mënyrë e përshkrimit nuk është e mjaftueshme nga këndvështrimi i gjykimit të drejtë. Gabimi i njëjtë është bërë me akuzën numër dy. As i pandehuri dhe as gjykata nuk mund të kuptojnë se çka është diapazoni i aktakuzës.

Pastaj prokurori kopjon fjalët nga ligji: “me synimin e përfitimit të kundërligjshëm për ta ose për palën e tretë”. Alternativa e paraparë me ligj (dispozita 267§2) lejon përshtatjen e drejtë të përmbajtjes dhe të gjendjes faktike me rezultatin e procedurës së provave. Ajo nuk duhet të merret dhe të kopjohet pa asnjë pasqyrim të saj. Gabimi i njëjtë është bërë në akuzën dy dhe tre.

Në fund akuzat në aktakuzë nuk duhet të përpilohen si “gjendje faktike” të vogla. Ato duhet të editohen në mënyrë të koncize dhe të përpiktë duke i përfshirë rrethanat themelore ligjore sipas dispozitave përkatëse të kodit penal.

Gjithashtu ka edhe shumë pyetje të tjera në aktakuzë që janë lënë pa përgjigje. Kur kanë përdorë ata kërcënimet dhe dhunë konkretisht. Në çfarë mënyre? Cilat janë kriteret objektive të një situatë të vështirë financiare? Cilat kanë qenë saktësisht kushtet e “borxhit” nëse janë ofruar nga të pandehurit? A mund të dallojmë sjelljen e secilit të pandehur për të kuptuar se cilat aktivitete në të vërtetë janë ndërmarr individualisht nga secili prej tyre? Si është e mundur që gjatë praktikës penale të përshkruar në aktakuzë M.K ishte duke vuajtur dënimin e tij dhe njëkohësisht është akuzuar për veprën penale

sipas aktakuzës? A ka vepruar ai prej burgut? Nëse po, si kontribuoi ai veprës penale të përshkruar në aktakuzë? Në anën tjetër nëse T.K po vepronte vetëm si “kuti postare” ose “korrier” për debitorin, a ka ndonjë provë se ai ishte i vetëdijshëm për faktin se paratë e dhëna vëllait të tij nga pala e dëmtuar duhet të konsiderohet si “përfitim i kundërligjshëm”?

#### Vërejtjet e tjera mbi deklaratën e PD.

Ne faqen 7 të aktakuzës ndodhet një fjali që thotë “gjendja e tillë faktike është vendosur derisa pala e dëmtuar u dëgjua në cilësinë e dëshmitarit (...)”. Në anën tjetër prokurori vërejtë disa parregullsi dhe kundërshtime të deklaratës së palës së dëmtuar Sh.M si një nga borxhet e marra nga Ar.B. Sipas mendimit të gjykatës deklarata e palës së dëmtuar përmban shumë parregullsi, jo vazhdimësi, jo koherencë, kundërshtime dhe mospërputhje përkitazi me të gjithë shtatë të pandehur dhe jo vetëm me Ar.B i cili është përjashtuar si i dyshimtë nga lënda veç në fazën paraprake. Mirëpo ka edhe më shumë nga ato parregullsi, jo vazhdimësi, jo koherencë, kundërshtime dhe mospërputhje se sa që është vërejtur nga gjykata. Kjo gjithashtu bëri që gjykata të vjen në përfundim se nuk është e mundur të sajohet gjendja faktike objektive duke u bazuar vetëm në deklaratën e Sh.Mt. Gjykata jep argumentimin e hollësishëm mbi të në arsyetimin e tanishëm.

#### Pozita e S.Kt.

Aktakuza e trajton S.Kn si njërin nga të pandehurit të përrshirë në detyrimin ndaj palës së dëmtuar duke vepruar si pjesëtar i bashkimit të supozuar. Sipas aktakuzës i pandehuri S.K ishte i përrshirë me qëllim që të shtyjë afatin e pagesës së borxhit dhe të kamatës por ai kërkoi 3000 euro nga PD si shpërblim për ndërmjetësimin e bërë midis tij dhe të pandehurit T.K. Disa rreshta më vonë pala e dëmtuar thotë se 2000 euro ishin për T.K për shtyrje dhe të tjerat për S.Kn (f.15, procesverbali i 13 shtatorit). Sipas supozimit PD nuk kishte mundësi për të mbuluar kërkesa të tilla ndaj S.Kt dhe ky i fundit e mori veturën e tij Golf. Rrethana më lart nuk e pasqyrojnë të vërtetën. Sipas dëshmitarit B.M, ishte vetë Sh.M ai i cili kërkoi borxh prej 7.000 eurove. Dëshmitari nuk e ka pasur këtë shumë parash. Atë ditë Sh.M e vizitoi atë dy herë atë ditë. B.M e kontaktoi atë me shokun e tij S.Kn. Mt i janë dhënë paratë nga K pa asnjë kamatë. Si garanci për borxhin S.K mori

veturën e Sh.Mt dhe PD e barti të drejtat e veturës te S.K. Në ndërkohë kur erdhi koha e kthimit të parave Sh.M shkoi në Shqipëri me veturë. Duket qartë se Sh.M e falsifikoi dokumentet e veturës dhe e ktheu veturën te emri i tij. Për këtë Sh.M është ndjekur (shih provën C3 dhe C13). Sipas dëshmitarit Sh.M vullnetarisht i dha çelësat S.Kt. Në kufi Mo dhe K e raportuan M policisë dhe prona e veturës u kthye përsëri te S.K. Dëshmia e këtij dëshmitari B.M ishte koherente dhe plotësisht në përputhje me deklaratën e dhënë nga i pandehuri S.K. Nuk ka asnjë provë se Se është “pjesëtar i grupit” në kuptimin e paraparë me nen.267§2 të KPK. S.K nuk ishte duke vepruar në emër të S.Nt dhe vëllezërve K. Pala e dëmtuar pranoi se nuk ka pasur asnjë përdorim të kërcënimit ose forcës nga K ndaj Mt. Duke i analizuar rrethanat në mënyrë teorike të parapara me nen. 270 KPK ato gjithashtu nuk plotësohen për shkak të mungesës së provave për përfitimin jo proporcional me S.Kn i cili mezi mori prapa garancinë e borxhit në formën e veturës. S.K deklaroi se ai e shiti atë veturë për 6.300 euro që ishte më pak se borxhi jo i kthyer i dhënë Mt.

*Përfshirja e A.B në shitjen e supozuar të detyruar të parcelës së tokës që i takonte PD.*

Bartja e pronës së paluajtshme (tokë bujqësore, tokë ndërtimi, pyll dhe tokë pylli, ndërtesat, banesat, lokalet afariste) gjatë periudhës në fjalë 2007-2008 është rregulluar nga ligjet vijuese: a/Ligji mbi bartjen e pronës së paluajtshme të Kosovës (i shpallur në Gazetën zyrtare të KSA Kosovës Nr. 45/81, 29/86 me plotësimet prej datës 31.12.1990); b/Ligji për gjykata të rregullta me plotësimet (Gazeta zyrtare KSAK Nr.21/78, e plotësuar 2/89); c/Ligji mbi bazat e marrëdhënies pronësore (Gazeta zyrtare RSFJ, Nr. 6/80, 36/90 (i cili ishte i zbatueshëm deri në vitin 2009); d/Ligji mbi kontratat dhe detyrimet (Gaz. zyr. RSFJ", nr. 29/78, 39/85, 45/89 i 57/89); e/Ligji mbi vërtetimin e nënshkrimeve, dorëshkrimeve dhe kopjeve (që nga 1971); f/Ligji mbi themelimin e regjistrave e të drejtave për pronë të paluajtshme (Ligji Nr 2002/5, UNMIK/REG/2002/22 e plotësuar nga Ligji Nr 2003/13 mbi Plotësimet dhe shtesat, e shpallur nga Reg. e UNMIK-ut 2003/27, në fuqi që nga data 18.08.2003). Nën nen. 455 të LKD kontrata e shitblerjes së pronës së paluajtshme duhet të jetë me shkrim; përndryshe do të jetë e pavlefshme dhe e pavlerë. Neni 33 i Ligjit mbi bazën e marrëdhënieve pronësore parasheh se në bazë të punës ligjore e drejta e pronësisë mbi pronën e paluajtshme do të fitohet me regjistrimin



në “regjistrin publike- librat kadastrë” ose me ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme që parashihet me ligj.

Neni 26 (14) i Ligjit mbi Gjykatat e rregullta parasheh që gjykatat komunale janë kompetente për të vendosur mbi procedurën e trashëgimisë, procedurën e përbarimit, procedurën e regjistrimit e të drejtave mbi pronën e paluajtshme, në rastet e ndarjes fizike, duke rregulluar çështjen e kufijve, vërtetimin e transkriptove, dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve, si dhe në çështjet e tjera jashtë gjykate të cilat janë, me ligj, vendosur nën juridiksionin e gjykatës.

Gjithashtu, sipas Pjesës 7.1 të Ligjit mbi themelimin e regjistrit e të drejtave të pronës së paluajtshme (Ligji Nr 2002/5, UNMIK/REG/2002/22 e plotësuar me Ligjin Nr 2003/13 mbi plotësimet dhe shtesat, e shpallur nga Reg. e UNMIK-ut 2003/27, në fuqi që nga data 18.08.2003) njëherë kur të themelohet Regjistri, asnjë bartje e mëpasshme e të drejtave të pronës së paluajtshme nuk do të jetë efektive përderisa nuk regjistrohet sipas këtij ligji.

Nuk ka dyshim se parcela e tokës e përmendur në aktakuzë është ngastra Nr 5215/4 600 m<sup>2</sup> në Komunën e Prizrenit, afër “Restorantit “Mena”. Ekziston konfirmimi i vlefshëm i kontratës nga Agjencia e kadastrës së Kosovës. Palët në kontratë janë A.B dhe Sh.S. Pala e dëmtuar pohoi se ai ishte pronari i tokës por sipas dokumenteve ai nuk ishte. Prova E9 e lëshuar por organet publike të Kosovës kurrë nuk janë nënvlerësuar nga askush. Duke marr parasysh formën mandatorë të marrëveshjes dhe miratimin e saj formale nga Agjencia e kadastrës së Kosovës të datës 11.12.2008 nuk ka asnjë mënyrë ligjore për të shpallur marrëveshjen të pavlerë. Aktvendimi (Prova E9) përmban udhëzimet për këshillat juridike. Po të ishte i pakënaqur PD duhej të kishte ushtruar ankesën por nuk e bëri.

Prova tjetër mbështetëse është dëshmia e S.Jt i cili dëshmoi se parcela është shitur A.B nga Sh.S (procesverbali i datës 14.09.2011). O.B dhe S.J ishin të dy të pranishëm në çastin kur kontrata është përfunduar dhe kur kësti i parë prej 30.000 eurove është paguar. Sipas dëshmitarit gjithçka ishte me leje dhe në marrëveshje të përbashkët. Sh.M pohoi ndryshe mirëpo versioni i tij ishte i palogjikshëm dhe nuk ishte i mbështetur nga asnjë provë përveç deklaratave të tij. Nuk ka asnjë provë për përfshirjen e A.B në veprën penale nga nen.267§2 KPK, nuk ka pasur asnjë shenjë të veprimit si “pjesëtar i grupit”; pala e dëmtuar mohoi çdo përdorim të forcës ndaj tij nga A.B. Sh.M deklaroi se

A.B nuk ishte i përfshirë në shtypjen ndaj tij (procesverbali i datës 13.09.2011, faqe 20) dhe ai ishte tolerant dhe i sigurtë (procesverbali i datës 14 shtat. faqe 6). Natyrisht nuk ka asnjë provë ligjore e vlefshme mbi vërtetësinë e supozuar të kontratës së shitblerjes të parcelës së përmendur në aktakuzë e cila gjithashtu do të thotë mungesa e provave mbi çdo përfitim pasuror nga ana e A.B dhe asnjë dëm në anën e palës së dëmtuar.

Pozita e N.Kt.

N.K pranoi se ai i ka dhënë Sh.Mt borxh me afat të shkurtër prej 50.000 eurove por pa asnjë kamatë. Paratë nuk i janë paguar deri në fund të gjykimit. Dëshmitari A.Br gjithashtu vërtetoi se faktin se N.K i ka dhënë para palës së dëmtuar. Sh.M pohoi se sipas dëshmitarit se ai ka dy ngarkesa të tekstit në Serbi që vijnë nga Singapori. Ai i dha N.Kt këtë argument si arsye për të kërkuar borxh. N.K në fillim nuk u pajtua por më vonë mori vendimin pozitiv duke marr parasysh faktin se Sh.M ka pasur shumë shitore prandaj dukej se ishte në gjendje të paguaj borxhin e tij. Ata u pajtuan që Sh.M të kthejë borxhin në afat prej dy javësh deri në një muaj. Kjo u rregullua në shitoren e Shit. Të dy dëshmitarët dhe të pandehurit dëshmuar se nuk ka pasur kamatë meqenëse ishte borxh me afat të shkurtër. Përveç deklaratës së Sh.Mt nuk kemi asnjë provë mbështetëse për shumën e kamatës nëse edhe ka pasur. Duke pasur ndërmend palogjikshmërinë e deklaratës së palës së dëmtuar gjykatës nuk i lejohet t'i trajtojë ato si të besueshme dhe besnike. Vlen të përmendet se edhe vetë prokurori nuk e mori dëshminë e tij si të besueshme sa i përket Ar.B duke i përjashtuar supozimet ndaj tij në fazën e hetimeve. Ekziston edhe një element tjetër i rëndësishëm faktik se ky borxh kurrë nuk i është kthyer N.Kt i cili vetëm mori ca mallra nga shitorja e Sh.Mt si kthim i parave për shumën që nuk kalonte 12.000 euro. (krahaso deklaratën e N.Kt, procesverbali i datës 15.09.2011, faqe 9). Asnjë para tjetër nuk është kthyer. Duhet të kujtojmë gjithashtu se pala e dëmtuar gënjeu N.Kt duke thënë se atij i duhej paraja për të paguar mallrat që vinin nga Singapori. Duke marr parasysh qëndrimin e Sh.Mt të pranuar nga ai gjatë shqyrtimit gjyqësor se ai huazonte para për të kthyer borxhet e marra më herët gjykata vjen në përfundim se faji i N.Kt nuk është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

Sa i përket elementit mental të veprës penale të paraparë me nen.270 të KPK për kontraktim të përfitimit jo proporcional nuk është e mjaftueshme të dëshmohet fakti se “shuma jo proporcionale e dukshme” është negociuar “në kthim”. Ekzistojnë

edhe elementet tjera mentale të qëllimit penal për t'u plotësuar si janë kryerja e veprës penale duke e shfrytëzuar rrethanat e vështira financiare të personit të dëmtuar, rrethanat e vështira të banimit, varfërinë, papërvojën ose paaftësinë për të gjykuar. Asnjë nga këto elemente nuk janë dëshmuar nga prokurori sa i përket N.Kt. Do të ishte madje e papërshtatshme të pohohet se dikush i cili në një anë e prezanton veten si afarist i suksesshëm dhe në anën tjetër në gjykatë deklaroi se merr borxh me qëllim që të kthejë kreditorëve tjerë është dikush i papërvojë ose i paaftë të gjykojë. Si rrethanë e vështirë financiare në anën e N.Kt nuk ka pasur asnjë dëgjim për këto rrethana. Me shumë gjasë ai nuk do të pajtohej të jep borxh po të dinte këtë. Duke supozuar madje se kontrata, e pafavorshme për palën e dëmtuar, është lidhur elementet e tjera të përmendura më lart të veprës penale nuk janë përmbushur. Gjykata duhet të përfundojë se asnjë veprë penale nuk është kryer nga ana e N.Kt për shkak të mungesës së këtyre elementeve të lartpërmendura të veprës penale të paraparë me nen.270 të KPK.

#### *Pozita e V.Kt.*

Dëshmitari F.B u dëgjua në gjykatë. Versioni i deklaratës së tij të dhënë në gjykatë shmanget shumë nga versioni i dhënë në fazën paraprake. Dëshmia e dhënë policisë është shumë e shkurt dhe përmban vetëm elementet themelore të cilat me supozim përcaktojnë veprën penale të fajdes të paraparë me nen 267 §2 të KPK. Dëshmitari në deklaratën e tij përmendi se Sh.Mt i është dhënë borxh prej 10.000 eurove me kamatë mujore prej 10 %. Gjatë seancës gjyqësore ai e ndërroi versionin. Nuk ishte i sigurt për shumën e borxhit të marr nga M. Ai deklaroi se kjo ishte 5.000 ose 10.000 euro. Ai nuk e mbante ndërmend për kursin e kamatës së borxhit. Ai tha se ai i la ata vetë, pranë derës afër zyrës dhe se nuk e dinte marrëveshjen. Sipas mendimit të gjykatës dëshmitari nuk ishte besnik. Duke supozuar se borxhi vërtetë i është dhënë Sh.Mt pyetja është problematike sa i përket elementeve të tjera që e përbëjnë veprën penale. Nuk ka asnjë provë mbështetëse për kërcënimet dhe as për përdorimin e dhunës. Ky dëshmitar nuk e vërteton rrethanat e kërcënimeve dhe të dhunës nga V.K. F.B përmend vetë kërcënimet e bëra nga Ar.B dhe jo nga A.B. Ajo çka vlen të përmendet në këtë pikë është se prokurori i pushoi hetimet ndaj Ar.B madje pasi u njoh me këtë dëshmi çka do të thotë se edhe madje zyra e prokurorisë nuk i beson këtij dëshmitari. Prokurori theksoi në

arsyetimin e aktakuzës se lidhur me këtë ka disa parregullsi dhe kundërshtime në deklaratën e palës së dëmtuar mbi borxhet e marra nga Ar.B. Kjo e shtyri deri te përfundimi se hetimet për këtë pjesë duhej të kishin pushuar madje duke pasur ndërmend dëshminë e F.Bit. Kjo është edhe një arsye tjetër që dëshminë e F.Bit duhet ta shikojmë nga një distancë e duhur dhe besueshmëria e tij duhet të përfillet si e kufizuar. Nuk ka pasur asnjë provë për përfshirjen penale të V.Kt në bartjen e pronës së paluajtshme të përshkruar në aktakuzë. Prokurori nuk dëshmoj se i pandehuri ishte “pjesëtar i grupit” në kuptimin e paraparë me nen. 267§2 të KPK prandaj kjo dispozitë nuk është i zbatueshëm. Nuk është dëshmuar se i pandehuri përdori ndonjë kërcënim ose dhunë në kthimin e parave të tij si është përshkruar më lart prandaj gjithashtu edhe nen.267 §1 i KPK nuk është i zbatueshëm. Sa i përket cilësimit alternativ ligjor të veprës penale me nen.270 të KPK të kontraktimit të përfitimit jo proporcional nuk është e mjaftueshme vetëm të dëshmohet fakti se “shuma e dukshme jo proporcionale” është negociuar “në kthim” por ekzistojnë edhe elementet tjera mentale të qëllimit penal si janë kryerja e veprës penale duke e shfrytëzuar rrethanat e vështira financiare të personit të dëmtuar, rrethanat e vështira të banimit, varfërinë, papërvojën ose paaftësinë për të gjykuar. Asnjë nga këto elemente nuk janë dëshmuar nga prokurori. Pala e dëmtuar në njërin anë e prezanton veten si afarist të suksesshëm dhe në anën tjetër në gjykatë deklaron se merr borxh për të paguar kreditorët e tjerë. Si mund të pohon ai se kinse është dikush i papërvojë dhe i paaftë për të gjykuar? Sa i përket rrethanave të vështira financiare nga ana e V.Kt nuk ka pasur asnjë dijeni për këto rrethana. Ndonëse i pandehuri rrjedhimisht mohon çfarëdo borxhi të dhënë të pandehurit dhe nëse kemi ndërmend faktin se dhënia e borxhit nuk është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm, në kuptim teorik V.K me shumë gjasë nuk do të pajtohej të jep borxh po të dinte për situatën e vërtetë të palës së dëmtuar. V.K fare nuk e njihje të pandehurin tjetër A.B.

Duke supozuar madje se kontrata e pafavorshme për palën e dëmtuar është lidhur elementet e tjera të lartpërmendura të veprës penale nuk janë përmbushur. Gjykata duhet të përfundojë se asnjë vepër penale nuk është kryer nga V.K për shkak të mungesës së elementit mental të veprës penale të paraparë me nen.270 të KPK. Duhet të theksojmë se nuk ka pasur gjithashtu asnjë provë mbështetëse mbi shumat plotësuese të huazuara Mt nga Ky asht si është përmendur në aktakuzë.

Gjykata dëshiron të përdorë këtë mundësi për të theksuar se rrethana e vështirësive financiare duhet të jetë objektive dhe të dëshmohet në mënyrë objektive dhe për më shumë derisa ky është elementi që e përbën veprën penale kjo rrethanë duhet të regjistrohet në vetëdijen e të pandehurit në kundërshtim me atë çka ka ndodhur në çështjen lëndore. Ajo çka vlen të theksohet është dëshmia e Ar.B i cili deklaroi se Sh.M “është plotësisht fals”; “ai kishte veturën e mirë, katër butikë, femra rreth tij, katër telefona mobil, shkonte në Turqi çdo javë dhe më bindi se është shefi i Prizrenit”; “mos i besoni asaj çka shihni. Ai është fals dhe më shqetëson mua. Mu duhen tre muaj për të kuptuar se kush është ai.”(procesverbali i shqyrtimit kryesor, 14.09.2011, faqe nr.42).

Duke marr parasysh të gjitha argumentet e lartpërmendura dhe përmbajtjen e nen.396 paragrafi 9 KPPK gjykata është e detyruar të vë në pah në arsyetim nen.390 paragrafi 3 KPPK si arsye e drejtpërdrejt e lirimit. Nuk është dëshmuar se të pandehurit e kanë kryer veprën për të cilën akuzohen.

Witold Jakimko  
Kryetari i trupit gjykues

---

Vlora Johnston  
Procesmbajtësja

---

**KËSHILLA JURIDIKE:** Në pajtim me nenin 398(1) të KPPK, është e lejuar ankesa nga personat e autorizuar kundër këtij aktgjykimi në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dërgimit të kopjes së aktgjykimit.